

CEREMONI RITUALE NË KREMTIMIN E SHËN EREMISË DIKUR EDHE SOT

Edibe SELIMI-OSMANI¹

Abstrakti

Një vend të rëndësishëm në etnokulturë zënë mitologjia e besimet popullore me ritet e tyre përkatëse. Ato janë, në një mënyrë, a në një tjetër, shprehje e jetës shoqërore e shpirtërore të popullit. Zanafillën e tyre ato e kanë në kohë shumë të vjetra e kanë evoluar bashkë me kushtet e bashkësisë njerëzore. Kanë përmbajtje të theksuar shoqërore dhe lidhin të kaluarën e lashtë të popullit tonë me të tashmen. Duke parë vlerën e veçantë të besimeve popullore e të riteve të tyre me eksplorime terreni kemi mbledhur një material të konsiderueshëm për festat e ritet e motmotit.

Në studimin tim do t'i qasem ritualit që kryheshin në vigjilje të *Shën Eremisë*, vetëm në rrafshin sinkronik, pra, do të rrekem të shqyrtoj domethënien e tij vetëm në atë gjendje që ka qenë, kur janë regjistruar të dhënat për këtë praktikë pagane, të modifikuar gjatë shekujve dhe tekstet poetike që i referohen asaj.

Ceremonitë rituale të kësaj kremte kanë të bëjnë më së shumti me mbetje të kultit të gjarpërit si kafshë htonike e mbijetuar në traditën popullore. Ata janë praktikuar më së shumti në krahinat malore ku banorët kanë patur më pak kontakt me qytetin. Është vërejtur se në ndërtesat e kultit nuk kryheshin ceremoni fetare.

Fjalë kyçe: *Rite pagane, mbetje, zvaranikët, kulti i gjarpri, (mos) praktikimi.*

Ceremoni rituale në kremten e *Shën Eremisë* dikur⁴⁸ në Rekën e Epërme.

Kjo ditë e shënuar kremtohej me 14 maj, pra në ditën e nëntë pas ditës së *Shën Gjergjit*. Është kremte e vogël verore. Te myslimanët e kësaj krahine e gjejmë me emërtimin *Dita e Eremisë*, te krishterët *Dita e Shën Eremisë*. Si banorët myslimanë ashtu edhe ata të krishterë në vigjilje të *Shën Eremisë*, kryejnë disa rituale që i udhëheq plaka e shtëpisë. Ato i kryejnë fëmijët deri në moshën 13 vjeçare. Fëmijëve u varet në qafë nga një zile. Ndonjëri prej tyre merr legenin ose ndonjë teneqe për të bërë më shumë zhurmë, e njëri mban një pishë të ndezur. Duke bërtitur dhe vrapsuar rreth e rrotull shtëpisë, ata shqiptojnë këto fjalë:

Ik e ik-e urith-ooo!
Se të mrrini Eremija,
Ik e ik-e urith-ooo!
Se t'dojsha⁴⁹ t'pojsha⁵⁰
Repkat⁵¹ e mia si kusija,
Repkat e Ilkut si kakërdhija.

⁴⁸ Gjatë ekspeditave të bëra në vitet 1995-98, në krahinën e Rekës së Epërme.

⁴⁹ t'dojsha⁴⁹të dogja,

⁵⁰ T'pojsha-të poqa

⁵¹ Repkat-patatet

Ik e ik-e urith-ooo!
Se t' dojshta t'pojsha
Kungujt e mi si kusija
Kungujt e Damjanit si kulumrija...

Duke përsëritur të njejtat fjalë, përmenden me radhë emrat e fqinjëve, si dhe të gjitha perimet. Në kohën kur fëmijët vrapojnë, gruaja then dega molle ose dardhe, vë potka të gjelbëruara, duke i bërë nder perëndisë së bimësisë për pjellori e mbarësi të bimëve të arave e të kopshteve. Sipas besimeve popullore, më së shumti bëhen rituale që gjatë vitit të largohen zvaranikët si gjarpërinjtë dhe urithët nga shtëpia e kopshti. Femrat nuk shpojnë me gjylypërë e as i përdorin krrabëzat. Sipas besimit popullor i zë gjarpëri. Pra, kjo festë ka të bëjë më së shumti me mbetje të kultit të gjarpërit që aq shumë ishte i njohur tek ilirët.

Albanologu Robert Elsie, thekson: “*Gjarpri ka qenë simbol i fuqishëm i ilirëve të lashtë, sidomos i atyre të Ballkanit jugor. Në periudhën romake, në Dardani, kishte altar kushtuar gjarpërinjve Drakon dhe Drakaena*”. (Elsie, 2005:49)

Në kujtesën e të moshuarve natën e *Eremisë* në orët e vona të rinjtë dhe të rejtat, pa dallim feje, mblihdeshin lagje-lagje, luanin lojën *Vangjellaz*, ku lojtarët përdornin si rekoizizë kokrat e misrit dhe të groshës. Kjo lojë luhej vetëm në vigjilje të kësaj kremte.

Gjatë bisedës me gratë e moshuara, kur e përmendim *Ditën e Shën Eremisë*, ata ia fillojnë këngës:

Bije shiu, rosa-rosa
Ditën e Shën Eremisë
mbillet grosha...

Familjet e krishtera që kanë për të mbjellur groshë *Ditën e Shën Eremisë*, ftojnë priftin në oborrin e shtëpisë së fshatit; prifti e stërpik farën e groshës të përgaditur për mbjellje me ujën e bekuar dhe prek groshën me kryqin duke kënduar meshën. Të njejtin rit e ndeshim edhe te popullsia myslimane me disa ndryshime. Zonjat myslimane sjellin ujë nga kroi i fshatit edhe ato e stërpikin groshën para se të mbjellin. Mbjellja e groshës bëhet para se të perëndoje dielli.

Me të drejtë është konstatuar nga shkencëtarët se me pranimin e krishterimit nga ana e paganëve, shumë doke e zakone të tyre u krishterizuan në formë, po në përmbajtje mbetën ato që ishin më parë. Kështu ngjanë me natën e *Shën Eremisë*, *Shën Gjergjit* e tjerë.

Fshatrat e Tetovës, janë në distancë të largët me ato të krahinës së Rekës, ceremonitë rituale përkojnë njëra me tjetrën, por në Tetovë me rrethinë ata i gjejmë mjaft të zbehta, pothuajse kanë mbetur vetëm në kujtesën e brezit të moshuar.

Edhe pse zakonet për dëmtuesit e tillë kryhen edhe në festat tjera pranverore, siç duket kjo bëhej më së shumti në mbrëmje përballë *Eremisë*. Në fsharat Cerovë, Merovë dhe Llarçë, të Tetovës, plaka e shtëpisë i udhëzon fëmijët, duke u dhënë mashë e kaci në dorë që ata të rrotullohen disa herë rreth shtëpisë dhe të bërtasin:

Eremej, deremej,
Hikni boll e xharpej,
se të mbrejni Eremeja,
do t'boje copa copa,
*dë të shtej në tre gjropa...*⁵²

⁵² Edibe Selimi-Osmeni, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit* (Shkup: 1997), f.84-86.

Po në këtë krahinë të Dervenit, ky ritual përcjellet me fjalët: *Hik boll' e xharpej, se ta mbrejni Eremija!*

Është e arsyeshme të thuhet se poezia magjiko religjioze, ligjërimi sublim, merr përmasën estetike dhe ate e ka pasur qysh në zanafillën e saj. Thuhet se të menduarit dhe të shprehurit e figurshëm i ka paraprirë të menduarit konkret emocional. Ai që recitonte një këngë jo vetëm komunikonte me forcat e qeniet e mbinatyreshme për të plotësuar një kërkesë, por edhe ndjente kënaqësi shpirtërore. (Papleka, 1999:23-46)

Në fshatin Dobërcë të Tetovës, për festën e *Eremisë* fshatarët tubohen në vendin e quajtur *Çelija*; të rinjtë ziejnë groshë dhe hanë së bashku në natyrë. Një formë tjetër e paganizmit me ceremoni të përafërta e hasim edhe në fshatrat tjera. Gratë nuk qepin me gjylopërë, me bindje se gjatë vitit *bije e na dëmton breshëri. Ditën e Eremisë*, vizitohen arat e mbjellura dhe në vrimat ku më parë është ngritur toka, vajzat vendosin vezë kllukë. Në çdo shtëpi ndizet zjarri, përndryshe besohet se gjatë vitit do të ketë shtëpia bolla e gjarpërnjë. E zonja e shtëpisë e fik zjarrin dhe përshpërit: *Me u përta shpeja, u fejk!* Ku besohet se duke kryer këtë rit, gjatë vitit, po u dogj ndonjë shtëpi, shtëpia e saj do të jetë e mbrojtur nga zjarri. (Osmani, 1997 Rite...:faq.84-86)

Ndër shqiptarët, gjarpri është i lidhur fort me shtëpinë dhe familjen. Ndaj, në rite e besime popullore shqiptare, gjarpri paraqitet si hyjni mbrojtëse e jetës, e mirëqenies dhe mbarësisë në familje. Vërejtëm në fshatrat Urviç, Jellovjan dhe Novo Sella e Sharrit të Tetovës, vajzës deri në moshën nëntë vjeçare për çdo kremte të *Eremisë*, të jetës së saj, nëna i thurte një *gërshet* me penj (tekstili) dhe rruaza shumëngjyrëshe që ka formën e gjarpërit, siç duket në foto. Ky aksesori përforcohej për bishtalecat e vajzës. Kur fshatarët dalin në natyrë, të afërmit e vajzës i dhurojshin asaj para. Sot ky ritual nuk praktikohet.

Është konstatuar se paraqitja e këtij arti motivor në ornamentikën popullore i mbeti besnik traditës popullore të krijimit, e ruajti si rallë ndonjë kult tjetër. Por, vlen të përmendim se gjarpri si element dekorativ zë vend të rëndësishëm në prodhimet e mjeshtërisë së artit. (Osmani, 2006: *Kulti i gjar. ndër shq. e Maq. f. 194*) Një vend meritohet lidhur me këto ornamente *Famur Doli* në studimin e tij *Ornamentika nga kompleksi i kultit të gjarpërit të shtëpisë e zbatuar në arkitekturën popullore të Kosovës* thekson: Në formë figurale realiste gjarpri u aplikua edhe në artefaktin etnografik shqiptar[...].

Madje, ç'është me shumë rëndësi, gjarpri i punuar nga vajza drenicase me penj (tekstil) dhe rruaza gati se në tërësi i shëmbëllen gjarpërit të vërtetë[...]. Për shkak të rëndësisë së madhe që kishte kjo *kafshë kulti në mbijetojat e besimit popullor shqiptar*, ishte traditë që vajzat para martesës ta punonin për *pajë*, dhe natën e dhëndërisë ta varnin në mure të "*çilerit*", prej nga nuk e largonin më. Kjo dukuri, si mbijetojë e besimit pagan, ndër shqiptarë u ruajt gjithandej, ngase kjo kafshë ktonike, përveç tjerash, simbolizonte edhe *pëlleshmërinë e gruas*. (Doli, 2009: f. 134-135)

Sipas etnologut Marko Kitevskit, zakonet dhe besimet e kësaj feste datojnë që nga e kaluara më e largët e njeriut. Kjo festë lidhet me një sërë zakonesh dhe besimesh, të cilat konsiderohen se janë në funksion të mbrojtjes magjike nga gjarpërinjtë, hardhucat dhe zvarranikët tjerë. Në vigjilje të festës, gjarpërinjtë dhe hardhucat ndjeken në mbrëmje. Zakonet, zakonisht i kryejnë fëmijët ose disa të rritur duke bërë titur: *Ik nga hardhucat dhe gjarpërinjtë*

*Jeremia po vjen... [..] Në Razlloshko,⁵³ qarkullon legjenda e njohur se Eremija, konsiderohet nëna e gjarpërinjve dhe në këtë ditë thirrej që t'i largonte gjarpërinjt nga njerëzit. Prandaj këndohej: *Иримије иримоцај су деуама, Куза ја ф поле- тие в зора, куза ја ф- зора, му ја ф-поле [..]* Përkthimi: *Eremijë mbledhi fëmijët, kur unë në fushë-ata në kodër, kur unë në kodër-ata në fushë...**

⁵³ Razlloshko, lugina e Razlogut, qytet Razlloshko ndodhet midis tre maleve : Rilës, Pirinit dhe Rodotit.

Në mesin e ritualeve të shumta në Ohër, *Eftim Sprostranov* ka shkruar: "Ritet e kësaj feste janë më të bujshme në vigjilje . Në mbrëmje nga një grup të rijsh ndjekin vrmat ku flejnjë gjarprijt. Çdo pjesëmarrës merr nga një lopatë prej metali, mashë dhe tenxhere. Vendosin prushin në lopatë, stërpikin me kation , bëjnë zjarr shkojnë në kopësh duke kërkuar gropat ku supozohet se ka gjarpërij. Ndezin zjarrin në gropë, bëjnë zhurmë me mashë dhe kaci duke bërtitur: " *Bezaj, bezaj zadypujy/Eme mu ja Eremuja... Përkthim: Ikni, ikni zvaranik/Ja ku është Eremija...*

Pas tymosjes kacijën e lënë në një skaj të fiket zjarri. Copat e thëngjillit Ditën e kremtes sa zbardhën dita hudhen në greminë. [...]

Rite të përafërta të kësaj feste janë shënuar edhe në Gjevgjeli, Zletovë, Kumanovë. Ata janë më të bujshme në vigjilje të kremtes . Në Veles, sipas të dhënave të shekullit të kaluar: Në mbrëmjen para kësaj feste kryheshin zakone interesante. Në çdo shtëpi një vajzë apo një femër merrte kacijën dhe mashën kështu duke trokitur nëpër cepat e shtëpisë brohorite: *bezajme zmuu u zyumepu ka de ude Eremuja!* Përkthim: *Ikni gjarpërij dhe hardhuca kur vjen Eremija...* Me të ardhur te dera e oborrit ajo hedh mashën dhe kacinë në rrugicë. Kështu besohet se u dëbuan gjarpërinjtë dhe hardhucat. [...] Edhe në Gjevgjeli, sipas shënimeve të *Stefan Tanovit, Eremia*, festohej më shumë nga gratë sesa nga burrat në këtë zonë.

Ata gjithashtu kujdeseshin që të mos tërhiqnin asgjë zvarrë, sidomos tojën e çorapit, të opengës dhe të ngjashme. Në të kundërtën gjarpërinjtë do të ishin tërhequr zvarrë pas tyre për një vit të tërë. Një përshkrim të zakoneve të tilla mund të gjenden edhe në koleksionin e *Vëllezërve Milladinovi*, në Strugë, *Ditën e Eremisë*, thehen poçe dhe çerepë. Në Kukush, sipas shënimeve të *Vëllezërve Milladinovi*, në vigjilje të *Eremisë*, përballë pragut të portës vendosin kryqin dhe një dru të gjatë: nga të dy anët digjet një copë bukë; mbi hunin tejkalojnë kafshët shtëpiake me besimin që të mos i vënë në dukje gjarpërinjtë; antarët e familjes trokasin me kaci në vrma dhe thonë: *ik, ik se po vjen Jeremia ...*⁵⁴

Sipas legjendës, profeti i Shenjtë *Eremija*, lindi në Anadoll afër Jeruzalemit, gjashtë shekuj përpara Krishtit. *Eremija* që në moshën 15 vjeçare, filloi të profetizonte me profecitë të *Dhiatës së Vjetër*. Për shkak se profecia ishte armiku i tij, ai shpesh hynte në telashe, ndaj në Egjipt e vranë me gurë. Për nder të tij festohet *Dita 14 / I V* (Lit. Nedelkoviq. M. (1990)⁵⁵

Ndërsa *Medi Fetiu*, në studimin e tij shkruan, se në anën e Kërçovës . *Eremëir* është një ditë motmotit e cila më së paku festohet në këtë anë dhe heq rrënjët nga një i krishter *Shën Eremiu*. Bie ditën e nëntë pas *Shën Gjergjit*. Varësisht nga rrethanat atmosferike, ceremonia e rastit mund të bëhet në mëngjes ose pasdite. Nuk ka karakter të gjërë është rit familjar ose merr pjesë vetëm një lagje. [...] Mr. Abedin Zenku, thot se në anë të Zajazit, kjo e kremte e ka humbur krejtësisht karakterin themelor religjioz dhe kremtohet si ditë që ka të bëjë me mirëvajtjen e prodhimeve të qumshtit.⁵⁶ [...] Një ose disa sish marrin nga një tepsi ose enë tjetër metali ku mund të mblidhet ujtë e shiut nëse bie, dhe dalin nga shtëpia që kanë në duar dhe përsërisin:

Er' e mëirë, shëini mëir
Er' e mëir eremëir
Gjith të mëirat në shtëpëi...
Por, këndohet dhe kështu;
Eremej, eremej,
Gjith të mejrat, në shtëpej,
Të këçijat, në mullej,

⁵⁴ Marko Kitevski, „Свети пророк Еремија 14/1.V “, *Македонски Празници*, 2001 Shkup, faq.157-162.

⁵⁵ Lidija Kovačeva, „Св. пророк Еремија,“ -Македонски народни приказни, обичаи и верувања –решник-*botoi* Графостил, Shkup 2019, faq.122.

⁵⁶ Shif më gjërësisht :Mr. Abedin Zenku Jehona, Shkup nr.3 /1979, faq.265.

*I hongërt dreçi,
Me xhith xharpej...*

Kështu vazhdojnë këngët nëpër kopsht, rreth shtëpisë e më gjërë. Nëse është kohë me shi, nga shiu i mbledhur në ato enë zihet kos dhe me këtë fillon etapa e re në përpunimin e bylmetit.⁵⁷ Siç vërrejmë nga vargjet e këngës dhe ceremonive rituale kjo e kremte ka të bëjë me erën e mirë dhe shiu, lutën të kenë shi për të dhënat bujqësore. Me të drejtë etnologu *Ukë Xhemaj*, konstaton se riti i shiut në religjionin popullor paraqet një ceremoni rituale simbolike.

Është ajo që ndërlihd dy bota për kuptimin mitologjik të panjohura, por që simbolizojnë jetën dhe përrirjen e saj.⁵⁸

Këtë veprim magjik e gjejmë me vargje edhe në trevën e Strugës⁵⁹.

*Eremoj,eremoj,
Balt e shoj, balt e shoj,
Hikni bolla e gjarpri,
Se t'u vrasim me shkopi!*

Pra, sa më tepër të gjurmojmë mënyrën tradicionale të të kremtuarit në të kaluarën e Shën Eremisë, aq më tepër hasim në pikëtakime të ngjajshme në mes të këtyre trevave etnografike. Edhe në Zhur Dita e Shën Eremisë, përfaqëson të kremten e vjetër pranverore pagane. Në Ditën e Shën Eremisë, fëmijët, duke i rënë legenit të vjetër i largojnë dëmsjellësit e fushës, me britën efektive:

*Jeremi, Jeremi boll e gjarpër
byti n'Dri...*

Gatimi i dheut për çerep dhe disa rite

Është vënë re nga mbledhësit e këtyre riteve se në vise të ndryshme të Maqedonisë, në këtë Ditë, bënin çerep të cilat bëheshin vetëm nga gratë që në vend të caktuar gërmojshin tokë të veçantë për këtë qëllim. Për shkak të kultit të bukës, si dhe për faktin se në çerep brumosen bukë të ndryshme rituale, gratë që bëjnë çerep vishen me rroba të pastra. Gratë e Tetovës dhe Gostivarit, kanë zgjedhur vetë vendin për të bërë çerep dhe kanë thënë: *Nuk boj m'kët vend çerep, se jon lajt grat, e de thehen çerepët.*

Besohej se gratë të cilat *Ditën e Eremisë*, bënin çerep, gjatë vitit ishin të mbrojtura nga gjarpërinjtë. Gruaja beronjë, Ditën e Eremisë pa zbardhur dita lahet në vendin ku fshataret bëjnë çerep. Gratë ia ngrohin ujin po aty. Gjatë ritualit marrin pjesë dy gra të moshuara. Njëra i hedh ujë, kurse tjetra e lan dhe shqipton fjalët: *Me nijet t'Allahut, çerepët t'mës rrojn, coullët e Hasimes t'rrojnë.*⁶⁰ Në Kumanovë, nga brezi i moshuar mësojmë se *Ditën e Eremisë*, gratë shtatzëna e kanë patur rreptësisht të ndaluar të bëjnë çerep. Në të kundërtën çerepët nuk rrojnë dhe thehen shpejt.

⁵⁷ Feti Mehdiu, "Riti i prezeshkës dhe disa rite të tjera të motmotit në anë të Zajazit, **botoi** Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore- Materiale nga sesioni shkencor mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979, Prishtinë 1983, faq.127-128.

⁵⁸ Ukë Xhemaj, *Shtresime kulturore*, (Prishtinë: Instituti Albologjik i Prishtinës, 2005), f.153-158.

⁵⁹ Shefqet Pllana *Krijimtaria poetike në ritet e notmotit ndër shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë, botoi* Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore- Materiale nga sesioni shkencor mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979, Prishtinë 1983, faq.78.

⁶⁰ *Edibe Selimi-Osmari*, II. Kremte të pranverës, **Shën Eremia**, Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit, Shkup 1997, faq.84-87

“Në Zhur, praktikohet gjithashtu vajzat të shkojnë në fushë për të sjellë në shtëpi botë për të maruar çerep”⁶¹. Këtë veprim magjik e përcjellin me vargjet:

*Ka me ra dilli n'vijë e n'vijë
Shkojmë me marrë botë për Jeremi...*

Në fshatrat e Opojës dhe Gorës (Kosovë) nxerrja e dheut për punimin e këtyre enëve bëhet në mënyrë të organizuar Ditën e Jeremisë. Jo vetëm nxjerrja por dhe gatimi i dheut shpërndaheshin me rituale të veçanta të shoqëruara me këngë të posaçme.⁶²

Edhe Stipçeviçi, ven në dukje se me origjinë ilire është edhe çerepi për pjekjen e bukës, i cili në Ballkan haset në një numër të madh prej epokës së vjetër të hekurit dhe të cilën sllavët e njohin në kohën kur u shpërngulën në këto vise⁶³.

Si përfundim del se kjo festë sot ka ngelur vetëm në kujtesë nga brezi i moshuar. *Shën Eremija* nuk kremtohet më gjithashtu nuk praktikohen ceremoni e rituale por vetëm përmendet si *Dita e Eremisë*.

Referencat

Doli, Flamur, *Ornamentika nga kompleksi i kultit të gjarprit të shtëpisë e zbatuar në arkitekturën popullore të Kosovës*, Departamenti i Arkitekturës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës.

Elsie, Robert *“Leksiku i kulturës popullore shqiptare, besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore”* faq.49.

Kitevski, Marko, „*Свети пророк Еремија 14/I.V*“, Македонски Празници, 2001 Shkup.

Kovačeva, Lidija „*Св. пророк Еремија*„ -Македонски народни приказни, обишай и верувања –решник-*botoi* Графостил, Shkup 2019, faq.122.

Mediu, Feti, *“Riti i prezeshkës dhe disa rite të tjera të motmotit në anë të Zajazit*, botoi Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore- Materiale nga sesioni shkencor mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979, Prishtinë 1983.

Mr. Abedin Zenku Jehona, Shkup nr.3 /1979, faq.265.

Onuzi, Afërdita, a-enët e zjarrit *“Poçeria popullore në Kosovë”*, *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji* 36 (Prishtinë: Instituti Albologjik i Prishtinës.

Papleka, Ndoc, *Kulte, rite, magji në traditën orale* (Tiranë: Botimet TOENA, 1999).

Pllana, Shefqet, *Krijimtaria poetike në ritet e motmotit ndër shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë*, botoi Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore- Materiale nga sesioni shkencor mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979, Prishtinë 1983.

Selimi- Osmani, Edibe, *“Kulti i gjarpërit ndër shqiptarët e Maqedonisë”*, botoi *Studime Albanologjike* 1, (Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2009)

Selimi-Osmani, Edibe, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit* (Shkup: 1997)

Stipçeviçi, Aleksandër, *Ilirët, historia, jeta, kultura*, Gjurmët ilire në Ballkan mbas shkatrimit të qytetërimit antik, Rilindja, Prishtinë 1980.

Tuda, Shpresa, *“Këngë të motmotit në nahien e Strugës”*, *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji*, VI 1976 (Prishtinë: Instituti Albologjik i Prishtinës, 1978).

Xhemaj, Ukë, *Shtresime kulturore*, (Prishtinë: Instituti Albologjik i Prishtinës

⁶¹ Shefqet Pllana, *Krijimtaria poetike në ritet e motmotit ndër shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë*, botoi Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore- Materiale nga sesioni shkencor mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979, Prishtinë 1983, po aty faq.78.

⁶² Afërdita Onuzi, **a-enët e zjarrit** “*Poçeria popullore në Kosovë*”, *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji* nr.36 (Prishtinë: Instituti Albologjik i Prishtinës, 2006), faq.154-156.

⁶³ Aleksandër Stipçeviçi, **Ilirët**, historia, jeta, kultura, *Gjurmët ilire në Ballkan mbas shkatrimit të qytetërimit antik*, Rilindja, Prishtinë 1980, faq.82.